



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1497/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Jeton Koca dhe Malsore Gashi Bajraktari-anëtarë, me Flakron Gashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1497/2023 të datës 07.12.2023 të parashtruar nga ankuesi kundër organit të punësimit/ Administratës Tatimore të Kosovës, në çështjen juridike "*masë disiplinore*", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3, nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 18.01.2024, mori këtë:

V E N D I M

- I. Shfuqizohen Masat disiplinore "*Vërejtjet me shkrim*" të datës 13.11.2023 të shqiptuara nga Zv. Udhëheqësi i Departamentit për Menaxhimin e Mbledhjes së Borxheve në Administratën Tatimore të Kosovës, ndërsa lënda e ankuesit kthehet në *rishqyrtim* dhe *rivendosje*.
- II. Obligohet Zv. Udhëheqësi i Departamentit për Menaxhimin e Mbledhjes së Borxheve që të bëjë zbatimin e këtij Vendimi brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, ashtu që duhet të rishqyrtoj dhe rivendos lëndën e ankues sikurse në pikën I të dispozitivit.
- III. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesi, i cili sipas shkresave të lëndës është e punësuar në Administratën Tatimore të Kosovës, me datë 07.12.2023 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 7363/2023 të regjistruar me shenjen A.nr.1497/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Shkresës me numër DMM/DIV3 NR.02/2022 të datës 13.11.2023 lidhur me shqyrtimin e masës disiplinore "*Vërejtjes me shkrim*".

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshill pretendon se Udhëheqësi i drejtpërdrejtë me rastin e shqiptimit të masës disiplinore janë zbatuar gabimisht dispozitat e ligjit material dhe është konstatuar gabimisht gjendja faktike ngase raportimit lidhur me veprimet e ndërmarra kanë qenë të rregullta.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, me datë 13.12.2023 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankueses të Administratës Tatimore të Kosovës, ndërsa me datë 18.12.2023 Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë së bashku me provat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave për marrjen e vendimit meritore ka administruar këto prova: Ankesën me shenjen A.nr.1479/2023 me numër të protokollit 7363/2023 të parashtruar nga ankuesi me datën 07.12.2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vërejtjen me shkrim të datës 13.11.2023; Akt emërimit të datës 06.01.2023 me përshkrimin e detyrave të punës; Vendimin për transferimin e ankuesit të datës 23.12.2022; Akt emërimit të ankuesit të datës 08.11.2019; Kërkesa për përgjigje në ankesë të datës 13.12.2023; përgjigja në ankesë të datës 18.12.2023; Formularin e vlerësimit të rezultateve në punës të datës 18.01.2023; Formularin e vlerësimit të rezultateve në punës të datës 24.01.2022; E-mailin e datës 11.01.2023 dërguar nga N.H për ankuesin; E-mailin e datës 19.01.2023 dërguar nga N.H për ankuesin; E-mailin e datës 02.02.2023 dërguar nga N.H për ankuesin; E-mailin e datës 02.03.2023 dërguar nga N.H për ankuesin; E-mailin e datës 15.03.2023 dërguar nga N.H për ankuesin; E-mailin e datës 04.04.2023 dërguar nga N.H për ankuesin; E-mailin e datës 25.04.2023 dërguar nga N.H për ankuesin; E-mailin e datës 11.05.2023 dërguar nga N.H për ankuesin; E-mailin e datës 15.05.2023 dërguar nga N.H për ankuesin; E-mailin e datës 06.06.2023 dërguar nga N.H për ankuesin; E-mailin e datës 09.06.2023 dërguar nga N.H për ankuesin; E-mailin e datës 04.07.2023 dërguar nga N.H për ankuesin; E-mailin e datës 10.07.2023 dërguar nga N.H për ankuesin; E-mailin e datës 02.08.2023 dërguar nga N.H për ankuesin; E-mailin e datës 04.09.2023 dërguar nga N.H për ankuesin; E-mailin e datës 13.09.2023 dërguar nga N.H për ankuesin; E-mailin e datës 04.10.2023 dërguar nga N.H për ankuesin; E-mailin e datës 13.12.2023 dërguar nga N.H për ankuesin; Shkresë e datës 06.10.2023 me shifër: ZDP198/2023; Rregullore e Brendshme e ATK-së me shifër 03/2023 e datës 06.10.2023.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi që ka shqyrtuar të gjitha provat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar që ankesa e ankuesit duhet të kthehet në *rishqyrtim* dhe *rivendosje*, sepse

Nga administrimi i shkresave të lëndës, gjegjësisht akt emërimit të ankueses të datës 06.01.2023 me shifër AE.Nr.596/2022, Kolegji i Këshillit ka konstatuar se ankuesi është i punësuar në Administratën Tatimore të Kosovës në pozitën e punës "Zyrtar i mesëm i mbledhjes së detyrueshme" në kuadër të Departamentit për Menaxhimin e Mbledhjes së Borxheve, Divizioni për Masa të Sforcuara të Mbledhjes, ndërsa me datë 13.11.2023 ankuesit i është shqiptuar masa disiplinore "vërejtje me shkrim" nga N.H-Zyrtar i lartë për masa të sforcuara/ zv. Udhëheqës Departamentit për Menaxhimin e Mbledhjes së Borxheve.

Kolegji i Këshillit nga shkresat e lëndës ka konstatuar se ankuesit i janë shqiptuar dy masa disiplinore "vërejtje me shkrim" dhe që të dyja janë të së njëjtës datë 13.11.2023 dhe janë shqiptuar nga N.H-Zyrtar i lartë për masa të sforcuara, me arsyetimin se ankuesi është përgjegjës për mos zbatim të procedurës së kontrollit konform Ligjit 03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat që ndërlidhet me konfiskimin e pasurive dhe kujdesin për kontrollet dhe ndërmarrjen e hapave të tjerë

procedural për bizneset që figurojnë në listën e borxhlinjve dhe se që të dy vërejtjet nuk janë përjashtuese ndaj njëra tjetrës (nuk përcaktohet se njëra shfuqizon, plotëson apo ndryshon tjetrën) përveç faktit se njëra përmban dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik (i cili është shfuqizuar me rastin e hyrjes në fuqi të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik), ndërsa tjetra përmban dispozitat e Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik.

Kolegji i Këshillit, me qëllim të vlerësimit të bazës ligjore të referuar nga shqiptuesi i masës disiplinore analizoi dispozitat e Ligjit Nr.08/L-1967 për Zyrtarët Publik nenit 55, paragrafi 1, nenit 56 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 dhe paragrafi 3 ku përcaktohet se: "55. Nëpunësja/i civil mban përgjegjësi disiplinore për shkelje të detyrave dhe përgjegjësive, në rastet kur nuk kryen detyrat që i janë dhënë, kur bën zbatim jo të duhur të tyre apo kur gjatë ushtrimit të tyre vepron në kundërshtim me Kushtetutën, ligjet dhe akte të tjera nënligjore në fuqi. Shkelja disiplinore mund të bëhet me veprim apo mosveprim; 56.1 Shkeljet e detyrave dhe përgjegjësive të punës mund të jenë: 1.1. shkelje të lehta; 3. Shkelje të lehta konsiderohen: 3.1. mungesa e paarsyeshme në punë deri në dy (2) ditë pune radhazi; 3.2. mosrespektimi i orarit të punës; 3.3. sjellja jo e mirë gjatë kohës së punës, me mbikëqyrëset/it, koleget/ët, vartëset/it dhe me publikun" dhe ka ardhur në përfundimin se me rastin e shqiptimit të masës disiplinore të ankuesit janë zbatuar gabimisht dispozitat e ligjit material, respektivisht baza ligjore në të cilën është thirrur ankuesi i referohet veprimeve të nëpunësve civil që kanë të bëjnë me shkelje të lehta, ndërsa në arsyetimin e masës disiplinore tek vërejtja e datës 13.11.2023 i referohet mos zbatimit të Ligjit 03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat e që ky konstatim lënë të kuptoj që bëhet fjalë për mos përmbushje apo neglizhimin për përmbushjen e detyrave të punës e të cilat sipas dispozitave të nenit 56 paragrafi 4 nën paragrafi 4.1 dhe 4.2 të të njëjtit ligj hyjnë tek shkeljet e rënda disiplinore, ndërsa masa e shqiptuar disiplinore "vërejtje në shkrim" sipas dispozitave të nenit 57 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik është masë që jepet vetëm për shkelje të lehta disiplinore.

Kolegji i Këshillit nga konstatimi i gjendjes faktike sipas shkresave të lëndës dhe analizimit të bazës ligjore ka ardhur në përfundimin se zv. Udhëheqës Departamentit për Menaxhimin e Mbledhjes së Borxheve me rastin e shqiptimit të masës disiplinore "vërejtje me shkrim" ndaj ankuesit ka zbatuar gabimisht dispozitat e ligjit material ngase, ankuesit masa disiplinore i është shqiptuar me arsyetimin për mos zbatim të procedurës së kontrollit konform Ligjit 03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat që ndërlidhet me konfiskimin e pasurive dhe kujdesin për kontrollet dhe ndërmarrjen e hapave të tjerë procedural për bizneset që figurojnë në listën e borxhlinjve, respektivisht mos përmbushje e detyrave të punës, e që sipas nenit 56 paragrafi 4 nën paragrafi 4.1, 4.2 dhe 4.4 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik një shkelje e tillë përcaktohet të jetë shkelje e rëndë, sikurse: "54.1. Shkeljet e detyrave dhe përgjegjësive të punës mund të jenë: 1.1. shkelje të lehta; 1.2. shkelje të rënda; 54.4. Shkelje të rënda konsiderohen: 4.1. mos përmbushja e detyrave të punës; 4.2. neglizhencë e vazhdueshme në përmbushje të detyrave të punës; 4.4. moszbatimi i dispozitave ligjore për përmbushjen e detyrave funksionale" ndërsa masat disiplinore lidhur me shkeljet e supozuara të cilat janë shkelje të rënda ka kompetencë t'i shqiptojë vetëm Komisioni Disiplinor sikurse përcaktohet me dispozitat e 58 paragrafi 1 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, si: "Masat disiplinore për shkeljet e rënda shqiptohen nga komisioni disiplinor", po ashtu sipas përshkrimit të detyrave të punës të ankuesit, udhëheqës i drejtpërdrejtë i tij është Udhëheqësi i Divizionit, nga rrjedh se në rrethanat e rastit konkret përveç asaj që u tha më lartë u konstatua se shqiptuesi i masës disiplinore Zv. Udhëheqësi i Departamentit për Menaxhimin e Mbledhjes së Borxheve nuk është udhëheqës i drejtpërdrejtë i ankuesit, prandaj me rastin shqiptimit të masës disiplinore të ankuesit është vepruar në kundërshtim me dispozitat e ligjit material ashtu që në kuptim të nenit 52 paragrafi

1 të Ligjit nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ku përcaktohet se: "Një akt administrativ është i paligjshëm nëse: 1.2. organi publik që e nxjerr ka vepruar pa pasur kompetencë; 1.4. është nxjerrë në kundërshtim me dispozitat që rregullojnë formën apo elementet e detyrueshme të aktit administrativ; 1.5. është në kundërshtim me ligjin material." dhe si e tillë vërejtja me shkrim e datës 13.11.2023 (të dyja vërejtjet) është akt administrativ i paligjshëm për shkak të shkeljeve të ligjit material dhe dispozitave të LPPA-së, ngase masa është shqiptuar nga zyrtari jo kompetent sikurse arsyetimi i dhënë në masën e shqiptuar hynë në kuadër të shkeljeve të rënda sikurse edhe arsyetimi i aktit të kontestuar lidhur me bazën e referuar ligjore është i mangët, ngasë për palën është e paqartë interpretimi dispozitave ligjore të dhëna si në aktin e kontestuar, prandaj mbi këtë bazë vërejtjet e datës 13.11.2023 janë shfuqizuar sikurse në dispozitivin e këtij vendimi ndërsa lënda kthehet për rishqyrtim dhe rivendosje tek organi që e ka nxjerr aktin e kontestuar.

Kolegji i Këshillit thekson faktin se, Zv. Udhëheqësi i Departamentit për Menaxhimin e Mbledhjes së Borxheve me rastin e rishqyrtimit të lëndës së ankuesit duhet të marrë përbazë pikëpamjet juridike të dhëna si në arsyetimin e këtij vendimi dhe nëse pas rivlerësimit të situatës së dhënë konstaton se ankuesi është përgjegjëse për shkelje disiplinore, fillimisht duhet të konstatojë se shkelja disiplinore në kuadër të cilave shkelje hynë duke marrë për bazë dispozitat e nenit 56 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrarët Publik dhe më pastaj të procedojë tutje me veprimet procedurale, ashtu që nëse konstatim bie që shkeljet e ankuesit janë të natyrës së lehtë disiplinore, masën mund t'ia shqiptojë Udhëheqësi i Divizionit gjegjësisht udhëheqësi i drejtpërdrejtë i ankuesit, ndërsa nëse shkeljet e ankuesit kualifikohen si shkelje të rënda më pastaj duhet të veprohet sipas dispozitave të ligjit material lidhur me hapjen e procedurës disiplinore pranë komisionit disiplinor të ATK-së, mirëpo në secilën rrethanë, akti përmes së cilës konfirmon vullnetin e organit publik që cenon apo supozohet se mund të cenojë të drejtat e palëve në procedurë që burojnë nga marrëdhënia e punës duhet të respektojë dispozitat e Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe të ligjit material.

Prandaj, nga se u tha si më lartë, Kolegji i Këshillit pas analizimit të shkresave të lëndës, konstatimit të gjendjes faktike dhe analizimit të dispozitave ligjore në fuqi, konstatoi sikurse në arsyetimin e këtij vendimi që aktet e kontestuara të shfuqizohen për shkak të paligjshmërisë së tyre, ndërsa meqenëse aktet ishin të paligjshme në kuptim të zbatimit gabimisht të ligjit material, Kolegji i Këshillit nuk vlerësoi lëndën në kuptim të shqyrtimit meritore nëse ankuesi ka kryer apo jo shkelje disiplinore, prandaj lënë e ka kthyer në rishqyrtim dhe rivendosje dhe tek pas evitimit të lëshimeve ligjore sikurse në konstatimin e këtij vendimi dhe procedimit tutje nga institucionin punëdhënës, më pastaj varësisht nga vendimmarrja ankuesi mund të parashtrojë ankesë në pajtueshmëri me dispozita e ligjit material, dispozitave të LPPA-së dhe dispozitave të ligjit për Këshillin.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 dhe 1.6 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.1497/2023

Flakron GASHI

Zyrtar i Lavtë për Baskëpunim Profesional



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Drejtorit të Përgjithshëm në Administratën Tatimore të Kosovës;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Administratën Tatimore të Kosovës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së